ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**616-24-3392-5-1-1**
Nr i brendshëm	**616 24 043 511**

Sa i përket tenderit për: **"122 Ndertimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit te ndriqimit publik" Lot 3**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

INLINE ENGINEERING sh.p.k

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Muj Krasniqi Ulpian

(Adresa)

Prishtinë ***10 000***

(Vendi) *(Kodi postar)*

049959410

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Valon Hasani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@engineering-rks.com
(Adresa elektronike)

13.09.2024
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 05.04.2024 Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 10.04.2024 Vendimi i AK: 30.08.2024 Kërkesa për rishqyrtim dt. 04.09.2024 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt:05.09.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së** **Neni 70 i LPP-së** **Neni 72 i LPP-së** **Neni 38 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik** **Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne me datën 30.08.2024 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku për LOT-3 është rekomanduar për kontratë OE JAVNA RAZSVETLJAVA . Ne baze te njoftimit kompania jone është eliminuar me arsyen si në vijim *"Nuk ka plotësuar kërkesat e DT për stafin teknik. Po ashtu nuk ka plotësuar kërkesat e DT për Listën e pajisjeve"*. Fillimisht po e sqarojmë se ne si kompani ne vlerësimin e parë jemi te pergjegjshem, pra jemi cilësuar si OE i përgjegjshëm, çuditërisht tani pas rivlerësimit po eliminohemi me arsye krejtësisht të pa bazuara edhe përkundër faktit që dokumentet tona kanë qenë të njëjtat qysh nga dorëzimi i ofertës. Pra fillimisht jemi te pergjegjshem, ndërsa tani po eliminohemi nga

AK, andaj ky veprim i të njëjtës është kundërthënës dhe diskriminues, kundrejt kompanisë tonë.

Në lidhje arsyen e eliminimit tonë, AK-ja ka dhënë një përgjigjje të përgjithësuar, duke mos e sqaruar se çka nuk kemi plotësuar për stafin teknik e çka për makineritë, andaj kjo arsye tregon qartë diskriminimin që po na bëhet neve si kompani.

Ju sqarojmë se arsyeja e AK-së është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme për faktin se ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat për stafin teknik e po ashtu edhe kërkesat në lidhje me mjetet mekanike të kërkuara.

Kur analizohen dëshmitë e prezantuara nga ana jonë mund të vërtetohet qartë se ne në ofertë tek lista e punëtorëve posedojmë komplet stafin të cilin e kemi të rregullt dhe stafin i cili është i angazhuar sipas nevojave të projektit. Ne lidhje me stafin ne i kemi bashkangjitur diplomat, kontratat, CV dhe referencën e inxhinierit, më poshtë shihet dokumenti i ngarkuar:

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	Dokumentet e kompanis ,deklarata nenbetimi,deklartata tjera,standartet iso te OE.rar
2.	Certifikata e prodhuesit ISO,ENCN,Autorizimi,datasheet dhe garancioni.rar
3.	MFA2H8030065648N.pdf
4.	MFA2H8035584751Q.pdf
5.	Raporti i Auditorit 2022.2021.pdf
6.	Raporti i Auditorit i vulosur Inline 2023.pdf
7.	Makineria se bashku me marrveshje per shfrytezim te makineris.rar
8.	Lista e puntorve se bashku me kontrata,cv,diplomat.pdf
9.	Kontrata ,CV dhe Diploma e SABRIS.pdf
10.	CV per puntor shtes.pdf
11.	Vendim mbi caktimin e Menaxherit të Projektit.pdf
12.	vlersimi i rriskut dhe certifikata e puntorve siguria ne pune.pdf
13.	240510100608_0001.pdf
14.	Lista e Referencave 10 05 2024.pdf
15.	Referencata e perditsuara 09 05 2024.pdf

Lista e punëtorëve në ofertë :

LISTA E PUNTORVE

Nr.	Emeri dhe Mbiemeri	Profesioni	Statusi	Nr.leternjoftimit
1.	Valmire Hoxha	Ekonomiste	Rregullet	1171435214
2.	Valon Hasani	Teknik I Elektros	Rregullet	1234603279
3.	Jetmir Shefqeti	Teknik I Elektros	Rregullet	1175133794
4.	Altrit Fazliu	Teknik I Elektros	Rregullet	1243407113
5.	Muhamet Gashi	Puntor-Teknik I Elektros	Rregullet	1170876837
6.	Amir Hasani	Teknik	Rregullet	1010201035
7.	Gani Potoku	Teknik I Elektros	I Angazhuar sipas nevojes.	1015022821
8.	Sami Krasniqi	Teknik I Elektros	I Angazhuar sipas nevojes.	2005370097
9.	Kushtrim Krasniqi	Teknik I Elektros	I Angazhuar sipas nevojes.	1240439332
10.	Nexhat Fazliu	Teknik I Elektros	I Angazhuar sipas nevojes.	
11.	Ismail Halimi	Teknik I Makineris	I Angazhuar sipas nevojes.	
12.	Valon Nasufi	Teknik I Makineris	I Angazhuar sipas nevojes.	
13.	Ardian Hasani	Inxhinjer I Elektros	I Angazhuar sipas nevojes.	2014386257
14.	Ali Hoxha	Inxhinjer I Elektros	I Angazhuar sipas nevojes.	
15	Qendrimi Hoxha	Teknik	I Angazhuar sipas nevojes.	1173791646
16	Granit Hoxha	Teknik	I Angazhuar sipas nevojes.	2173983657
17.	Sabri Graiqevci	Inxhinjer I Elektros	I angazhuara per kete projekt	

Nga faktet dhe argumentet e lartcekura vërtetohet se ne i kemi përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit në lidhje me stafin e prezantuar, mirëpo që autoriteti kontraktues në mënyrë tendencioze dhe në kundërshtim me të dispozitat ligjore të LPP-së na ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, pa ndonjë bazë ligjore.

Ndërsa në lidhje me arsyen e eliminimit tonë për mjetet e punës ju sqarojmë se edhe kjo arsye e AK-së është e paqëndrueshme për faktin se ne kemi prezantuar në ofertë listën me mjetet e punës dhe librezat e mjeteve dhe mjetet shtesë përmes marrëveshjeve nga bashkëpunëtorët tonë për shfrytëzimin e tyre. Shih dokumentet e ngarkuara:

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	Dokumentet e kompanis ,deklarata nenbetimi,deklartata tjera,standartet iso te OE.rar
2.	Certifikata e prodhuesit ISO,ENCN,Autorizimi,datasheet dhe garancioni.rar
3.	MFA2H8030065648N.pdf
4.	MFA2H8035584751Q.pdf
5.	Raporti i Auditorit 2022.2021.pdf
6.	Raporti i Auditorit i vulosur Inline 2023.pdf
7.	Makineria se bashku me marrveshje per shfrytezim te makineris.rar
8.	Lista e puntorve se bashku me kontrata,cv,diplomat.pdf
9.	Kontrata ,CV dhe Diploma e SABRIS.pdf
10.	CV per puntor shtes.pdf
11.	Vendim mbi caktimin e Menaxherit të Projektit.pdf
12.	vlersimi i rriskut dhe certifikata e puntorve siguria ne pune.pdf
13.	240510100608_0001.pdf
14.	Lista e Referencave 10 05 2024.pdf
15.	Referencata e perditsuara 09 05 2024.pdf

Lista me komplet mjete e punës:

SH.P.K "INLINE ENGINEERING" NR.IDENTIFIKUES : 811488495-LISTA E MJETEVE TË PUNËS

Nr.	Përshkrimi I Mjetit të punës	Prodhuesi	Nr.Regjistrimit	Viti I Prodhimit	Prona	Vrejtje
1.	Korpë Lartësi -19 metera	Mereceds Sprinter	01-919-KH	2001	Pronë e Kompanisë	
2.	Kamion Me Kran 4.5 tona	Man	01-918-OQ	2005	Pronë e Kompanisë	
3.	Kamionet me Rimorki-Transportues	Mercedes Sprinter	01-104-PR	2007	Pronë e Kompanisë	
4.	Pikap Combo	Opel	01-452-MJ	2003	Pronë e Kompanisë	
5.	Pikap Cady	Wolsfagen	01-563-JG	2005	Pronë e Kompanisë	
6.	Vetur	Mercedes	01-998-MB	2016	Pronë e Kompanisë	
7.	Eskavator -Bager 5.4 tonë	Komassu		2005	Pronë e Kompanisë	
8.	Instrument për Testim të tokzimit	Metrel		2020	Pronë e Kompanisë	
9.	Instrument per testim sekondar,injektim deri në 100A	Swerker		2008	Pronë e Kompanisë	
10.	Instrument për testim të mbrojtjeve	Omicron		2012	Pronë e Kompanisë	
11.	Paisje për terheqjen e kabllove				Pronë e Kompanisë	
12.	Papuqe per ngjeshjen e kockave			2021	Pronë e Kompanisë	
13.	Korp deri në lartësi 14m		01-235-UK	2006	Marrveshje per shfrytezim-Construction Group	
14.	Kamion me Kran dhe rimorko				Marrveshje per shfrytezim	
14.	Eskavator-Bager -SKIP		1993		Marrveshje per shfrytezim - MURSELI COMPANY	
15.	Cilinder për ngjeshje				Pronë e kompanisë	
16.	Kompresor për thyrje të betonit				Pronë e kompanisë	
17.	Burgi për shpim horizontal nën asfaltë				Marrveshje per shfrytezim	
18.	Makin për terheqjen e kabllove				Pronë e kompanisë	
19.	Kamion me rimorki mbi 3ton				Marrveshje per shfrytezim-Construction Group	

INLINE ENGINEERING SH.P.K INLINE

Ne vendimin e autoritetit kontraktues nuk mund ta cilësojmë ndryshe përveç se vendim diskriminues kundër kompanisë tonë, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit nuk jemi rekomanduar për kontratë, mirëpo përkundrazi jemi eliminuar për arsye krejtësisht të paqëndrueshme.

OE i rekomanduar për kontratë për LOT 3 JAVNA RAZSVETLJAVE është i papërgjegjshëm, për faktet si në vijim:

OE ne fjale ka ofertuar për LOT 2, 3 dhe 4 me këto tipe të dritave:

These samples were delivered for LOT 2, 3 and 4, as requested in the FDT and BoQ according to position 1, 2 and 3.

Product: Position 1 | **YASL 09 50W, YASL 19 50W, META STREET LIGHT 50W|**

Product: Position 2 | **YASL 09 100W, YASL 19 100W, META STREET LIGHT 100W|**

Product: Position 3 | **YASL 09 150W|**

Product Specification

Product Code	YASL-09-30	YASL-09-50	YASL-09-100	YASL-09-150
Input Wattage	40W	60W	100W	180W
Color Temperature	3000-6500K	3000-6500K	3000-6500K	3000-6500K
Luminous Flux	4200-4800 lm	6600-7500 lm	11000-12500 lm	19800-22500 lm
Input Voltage	AC90-305V	AC90-305V	AC90-305V	AC90-305V
Frequency Range	50/60Hz	50/60Hz	50/60Hz	50/60Hz
Power Factor	PF≥0.95	PF≥0.95	PF≥0.95	PF≥0.95
Color rendering index	Ra≥70	Ra≥70	Ra≥70	Ra≥70
Temperature of Working Condition	-40-50˚C	-40-50˚C	-40-50˚C	-40-50˚C
Humidity of Working Condition	20%-90%RH	20%-90%RH	20%-90%RH	20%-90%RH
LED Lifetime	50000h	50000h	50000h	50000h
Protection Grade	IP66	IP66	IP66	IP66
Installation Pipe Diameter	Φ50-60mm	Φ50-60mm	Φ50-60mm	Φ60-70mm
Installation Height	3-6m	4-8m	8-12m	10-14m
Net Weight	2.7kgs	4.0kgs	6.5kgs	12.8kgs
Gross Weight	3.0kgs	4.5kgs	7.0kgs	13.2kgs
Packing Size(mm)	490×250×210	560×250×210	675×315×155	895×400×175

POZICIONI NR.1

9. Fuqia e trupit ndriçues kërkohet 50W, ndërsa ky OE në katalogun e prezantuar ka ofruar fuqinë e trupit ndriçues me 60W ose 40W, pra nuk posedon fuqinë prej 50W te pozicioni nr.1
10. Janë kërkuar ndriçimi ne lumena te jete ≥150 lm/W nga katalogu i ofertuara shihet se është 125 lm-W,
11. Është kërkuar qe orët e punës jete gjatësia te jete >100000h nga katalogu dhe tipi i ofertuar shihet se ka ofertuara 50000h

POZICIONI NR.2

12. Janë kërkuar ndriçimi ne lumena te jete ≥150 lm/W nga katalogu i ofertuara shihet se është 125 lm-W,
13. Është kërkuar qe orët e punës jete gjatësia te jete >100000h nga katalogu dhe tipi i ofertuar shihet se ka ofertuara 50000h

POZICIONI NR.3

14. Fuqia e trupit ndriçues kërkohet 150W ne katalog ka ofertuara 180W nuk posedon 150W te pozicioni nr.3
15. Janë kërkuar ndriçimi ne lumena te jete ≥150 lm/W nga katalogu i ofertuara shihet se është 125 lm-W,
16. Është kërkuar qe orët e punës jete gjatësia te jete >100000h nga katalogu dhe tipi i ofertuar shihet se ka ofertuara 50000h

Nga faktet e lartcekura shihet qartë se vlerësimi, krahasimi dhe ekzaminimi i tenderëve nuk është bërë konform dispozitave të neni 59 të LPP-së, sepse trupi ndriçuesi i ofertuar nga OE rekomanduar për LOT 2 dhe LOT 3 nuk është prezantuar sipas parametrave teknike te kërkuara dhe është shume me i lirë se ai i kërkuar nga AK, për arsye se jetëgjatësia është për 50% me e ulët. G
gjithashtu edhe sasia e ndërrimit është për 20% me ulët se sa kërkesa sikurse dhe fuqia me e larte shkakton shpenzim më të lartë te energjisë dhe kosto me te lartë për AK.
Te gjitha këto kanë kosto dhe është normale që çmimi me të cilin ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë është më i ulët se oferta jonë për arsye se i njëjti ka ofertuar me trupa ndriçuese të cilët parametrat teknike i kanë më të ulëta nga ato që janë kërkuar nga AK.

Përderisa ne kemi prezantuar trupat ndriçues sipas karakteristikave te kërkuara, atëherë është normale që çmimi ynë është më i shtrenjtë se OE i rekomanduar për kontratë i cili është i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar ne tipet e deklaruara dhe katalogjet e prezantuara shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson te dhënat teknike për pozicionet 1,2,dhe 3 .
Ne tender dosje janë kërkuar dritat me ore te punës >100000h për pozicionet 1,2 dhe 3 ndërsa nga katalogu i ofruar shihet se i njëjti ka ofruar drita me ore te punës 50000 h me çka është ne kundërshtim të plotë me specifikat e kërkuara.

Ne me dt.06.09.2024 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku autoriteti kontraktues ka vazhduar me avazin e njëjtë duke na diskriminuar neve si kompani e përgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit, pasi që ka bërë refuzimin pa ndonjë argument konkret mirëpo me pretendime tendencioze.

E njëjta në lidhje me arsyet e eliminimit tonë nga aktiviteti i prokurimit, tani e ka zgjeruar vendimin për refuzim, ku e ka cekur se nga dokumentet e prezantuara janë me dokumente të rregullta vetëm 5 punonjës teknik. Fillimisht po e sqarojmë se ky pretendim i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se nuk janë analizuar në tërësi të gjitha dokumentet tona, sepse ne kemi prezantuar punëtorët të cilët i mbulojnë kërkesat për të gjitha lotet që kemi ofertuar. Mirëpo sa për të vërtetuar faktin se AK-ja po mundohet ta vë në lajthitje tani edhe organin shqyrtues të prokurimit, duke devijuar me fakte, atëherë ju sqarojmë se kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë *"Kurse për LLOTOT 2, 3, dhe 4 kërkohet minimum 5 punëtor të cilët duhet të jenë të çertifikuar për siguri në punë".*

Nëse kjo që e ka cekur AK-ja është e qëndrueshme atëherë shtrohet pyetja pse nuk jemi rekomanduar për njërin nga lotet, pasi që sipas AK-së ne i përmbushim kërkesat vetëm për 5 punëtorë. Ky veprim i AK-së tregon qartë diskriminimin që po i bën kompanisë tonë, sepse ne i plotësojmë kërkesat për të gjitha lotet, andaj nuk mund dhe nuk duhet të eliminohemi me arsyetime të tilla.

Sa i përket pajisjeve AK-ja tani e ka cekur se kinse neve na mungon dëshmia e pronësisë së eskavatorit me qiradhënësin Murseli Company, mirëpo edhe ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm sepse ne i posedojmë të gjitha dokumentet sipas kërkesës së AK-së. AK-ja këtë arsye nuk e kishte cekur në njoftimin mbi vendimin e saj, mirëpo tani po mundohet që me veprime të tilla duke shtuar arsye të eliminimit edhe pse të njëjtat janë të pa baza, të na cilësoj kinse si OE të papërgjegjshëm. Vlen të ceket fakti se edhe nëse do të mungonte një dëshmi e tillë atëherë AK-ja do të duhej të kërkonte sqarime shtesë konform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, mirëpo që një gjë të tillë nuk e ka bërë edhe pse ka qenë e panevojshme sepse ne e përmbushim kërkesën e dosjes.

E njëjta e cek se ne jemi ofertues me çmim shumë më të lartë se sa OE të rekomanduar për kontratë dhe se në rast se lënda do të kthehej në rivlerësim (arsyetim ky qe pretendimi ynë është i bazuar), ne nuk do të mund të shpalleshim fitues sepse çmimi është shumë i lartë në krahasim me OE të përgjegjshëm.

Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm sepse ka qenë vet AK-ja e cila na kishte vendosur te pergjegjshem në njoftimin mbi vendimin e parë, mirëpo tani ne duhet të rekomandohemi për kontratë për këtë lot sepse, ofertat tjera janë të papërgjegjshme. Ndërsa sa i përket çmimeve tona ne e sqaruam se çmimet e OE të rekomanduar për kontratë janë të lira sepse janë prezantuar produkte të cilat nuk janë sipas specifikave teknike të dosjes së tenderit.

Në lidhje me pretendimet tona ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë AK-ja nuk i ka analizuar në detaje, duke e cekur se të njëjtit janë të përgjegjshëm, ndërsa neve na ka cilësuar palë pa interes. Ky veprim i AK-së tregon qartë diskriminimin që po i bëhet kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm, sepse ne jemi palë direkte me interes në këtë aktivitet të prokurimit.
Ne jemi palë me interes në këtë aktivitet të prokurimit dhe kjo gjë vërtetohet nga dëshmitë dhe argumentet e prezantuara me kërkesë për rishqyrtim e edhe tani me këtë ankesë, përmes të cilave vërtetohet se ne jemi OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm.

Njëkohësisht AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.
Ndërsa pika (vi) e paragrafit 6 e nenit 7 të LPP-së e përcakton qartë që "*që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse*.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **INLINE ENGINEERING sh.p.k**
ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës **për Lot 3** dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i** ofertave të bëhet sipas dispozitave

ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Gjate këtij aktiviteti te prokurimit jemi dëmtuar ne vlere prej 10,000.00 dhe fitimet e llogaritura.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*